



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KORÇE

VENDIM

Nr. 10, dt. 01.10.2021

MBI MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE PËR PROJEKTET ME FINANCIM TE HUAJ

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Ligjit nr 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 09, datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021”, udhëzimin plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”, udhëzimin nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave në vlerën 4000 mije lekë, për Programin IPA Cross Border Greqi-Shqiperi 2014-2020, Projekti CLLD – CulTour.
2. Të miratojë rritjen e planit të shpenzimeve në vlerën 4000 mije lekë, për Programin IPA Cross Border Greqi-Shqiperi 2014-2020, Projekti CLLD – CulTour.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimin e territorit dhe këshilltare për projektet e Bashkimit European.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ara VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE PËR PROJEKTET ME FINANCIM TE HUAJ

Në kuadër të Programit IPA Cross Border Greqi- Shqipëri 2014-2020 dhe në vazhdim të implementimit të katër projekteve të filluara nga viti 2018, Këshilli I Qarkut Korçë ka filluar të implementojë një projekt të ri në partneritet me palen greke “Projekti CLLD – CulTour” me vlerë totale 164350 euro ose rreth 20 milion lek dhe afat kohor 2 vjecar.

Këshilli I Qarkut Korçë në buxhetin për vitin 2021 ka miratuar fonde për këtë projekt për para financim dhe pagesa TVSH për mundësimin e financimit të aktiviteteve të para.

Për realizimin e këtij projekti në presim disburisim e transhit të pare nga donator në masen rreth 20% ose në vlerë 4 milion lekë.

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ligjin nr 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, VKQ nr 09, datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021”, udhëzimin plotësues nr. 04 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”, udhëzimin nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, kërkojmë miratimin e rritjes së planit të të ardhurave në vlerën 4 milion lekë me kapitull 02, për projektin me financim të huaj IPA si dhe rritjen e planit të shpenzimeve në të njëjtën vlerë si me poshte:

- Projekti CLLD – CulTour 4000 mijeleke

Kjo do të bëjë të mundur disburimin e parafinancimeve të projekteve me fondet që do të celen nga Bashkimi Europian për një ecuri normale në realizim në afat të tyre.

Korce, më 20.09.2021

Liljana Pleqi

Drejtoreshë e Financës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 11, dt. 01.10.2021

MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2021

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 09 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e Fondit Rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2021 në vlerë 200 mijë lekë.
2. Fondi prej 200 mijë lekë do të përdoret si kontribut financiar për Bashkinë Erseke në kuadër të aktiviteteve që do të zhvillohen nga QKF Kolonje në zbatim të Projektit “Kolonja e piktoreve të vegjel”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI PERDORIMIN E FONDIT REZERVE TE KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2021

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2021”, Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit paraqet para Keshillit të Qarkut kërkesen për përdorimin e fondi rezerve për vitin 2021.

Bashkia Erseke në bashkëpunim me QKF Kolonje kanë përgatitur projektin

“Kolonja e piktoreve të vegjel” Edicioni i 3-te. Në këtë projekt do të përfshihen të gjitha QKF-te e Qarkut Korçë si dhe të gjitha shkollat kryesore 9/vjecare të rajonit tërë. Qëllimi i këtij projekti është të ofroje akoma me shumë fëmijet drejt gjinise së pikturës, binjakëzimit midis institucioneve dhe shkollave në rang Rajoni, pasurimin e jetës artistike të qytetit me aktivitete të një natyre të vecante, promovimin e Kolonjes nëpërmjet natyrës, kulinarisë dhe talenteve.

Sa me sipër Bashkia Erseke dhe QKF Kolonje i kanë kërkuar Keshillit të Qarkut mbështetje financiare në vlerë 200 mijë leke për të bërë të mundur financimin e shpenzimeve të nevojshme për realizimin e këtij projekti.

Mbështetur në kjo kërkesë i propozojmë Keshillit të Qarkut miratimin e përdorimit të fondi rezerve të planifikuar për vitin 2021 në vlerë 200 mijë leke si kontribut financiar për Bashkinë Erseke për realizimin e këtij projekti.

Korçë, më 20.09.2021

Drejtore e Financës
Liljana Pleqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 12, dt. 01.10.2021

MBI DISA NDRYSHIME BUXHETIN E KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2021

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2021”, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 02 date 17.03.2021 “Mbi disa ndryshime në buxhetin e Keshillit të Qarkut për vitin 2021 dhe miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2020”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë rialokimin e fondeve për financimin e projekteve të Programeve IPA Cross Border si më poshtë:
Pakesim fondi
Projekti “Save Water”
Gr. 00 Tit. 06330 Kap. 01 Art. 231 1000000 leke
Gr. 00 Tit. 06330 Kap. 01 Art. 602 6000000 leke

Shtese fondi
Projekti “Save Safe Water”
Gr. 00 Tit. 06330 Kap. 01 Art. 602 2000000 leke

Projekt “CLLD – CulTour”
Gr. 00 Tit. 08250 Kap. 01 Art. 602 5000000 leke
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, stafet e projekteve perkatase, Dega e Thesarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI DISA NDRYSHIME NE BUXHETIN E KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2021

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9935 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2021”, Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 02 date 17.03.2021 “Mbi disa ndryshime në buxhetin e Keshillit të Qarkut për vitin 2021 dhe miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2020”, Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit në bashkëpunim me stafet e projekteve ka ndjekur realizimin e programeve për pesë projektet me financim të huaj për periudhën 9/mujore dhe realizimin e prishem të tyre deri në fund të vitit.

Pa analizues që ju be gjendjes se fondeve për se cilin projekt si në Degen e Thesarit ashtu edhe në bankat e rivelit të dyte, si dhe nevojave për fonde për çdo projekt, në propozojmë rialokimin e fondeve për financimin e projekteve sipas programeve si më poshte:

Pakesim fondi

Projekti “Save Water”

Gr. 00	Tit. 06330	Kap. 01	Art. 231	1000000 leke
Gr. 00	Tit. 06330	Kap. 01	Art. 602	6000000 leke

Shtese fondi

Projekti “Save Safe Water”

Gr. 00	Tit. 06330	Kap. 01	Art. 602	2000000 leke
--------	------------	---------	----------	--------------

Projekt “CLLD – CulTour”

Gr. 00	Tit. 08250	Kap. 01	Art. 602	5000000 leke
--------	------------	---------	----------	--------------

Korce, me 21.09.2021

Drejtore e Finances
Liljana Pleqi



KËSHILLI I QARKUT KORÇË

INFORMACION

MBI DETYRIMET E TRASHËGVARA TË KËSHILLIT TË QARKUT DHE AMORTIZIOMIN E TYRE PËR PERIUDHËN 8/MUJORE

Ne zbatim të Ligjit nr. 137/2020 "Për Buxhetin e vitit 2021", Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 4 datë 25.01.2021 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021", Udhëzimit nr. 26 datë 27.09.2019 "Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njesitë e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 37 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin të periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme", Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 09 datë 18.12.2020 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021", gjatë periudhës 8/mujore është punuar për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e stokut të borxhit, pa krijuar vështirësi financiare në financimin e shpenzimeve të periudhës aktuale.

Gjendja e borxhit në 01 Janar 2021 ka qenë 2982 mijë lekë ndare si me poshte:

- Mallra dhe shërbime të tjera 1628 mijë lekë ose 54.6 % e detyrimit
- Vendime gjyqësore 1353 mijë lekë ose 45.4 % e detyrimit

Gjate kesaj periu dhe jane likuiduar gjithsej 259.4 mijë lekë ose 8.7 % të totalit të detyrimeve të trashëguara gjendje në 01.01.2021 duke likuiduar në total një rast të një vendimi gjyqësor sipas grafikut të përcaktuar.

Gjendja e borxhit në fund të periudhës 8/mujore është 2723 mijë lekë si me poshte:

- Mallra dhe shërbime të tjera 1628 mijë lekë
- Vendime gjyqësore 1094 mijë lekë

Të gjitha detyrimet i takojne periudhes para vitit 2015 ne nje kohe kur Institucioni ka kaluar veshtrësi financiare të trajtuara shume here ne Këshillin e Qarkut.

Ne baze te analizës se bere ne fund të periudhës 8/mujore detyrimet e trashëguara kapin 2.13 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara dhe institucioni është në një situatë financiare normale. Sitata e borxhit nuk demton ecurinë normale të punës të institucionit dhe rendësi mer takti që për disa vjet me tradhe Këshilli i Qarkut nuk ka krijuar asnjë borxh të ri. Në kemi planifikuar amortizimin e borxhit brenda Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023. Këshilli i Qarkut ka marrë të gjitha masat për zbatimin e këtij programi.

Bashkangjitur do të gjëni të gjitha tabelat që pasqyrojnë këtë situatë.

Lilijana Pleqi
Drejtoresh e Finances

Korçë, më 22.09.2021

KESHILLI I QARKUT KORÇE

Muaji _Shtatori I-re 2021

Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare

NELEKË

Situata Normale e gjendjes financiare	Rasti i vështirësuar ku ndodhet njësitja e vetëqeverisjes vendore		
	Probleme financiare Stoku i detyrimeve/Shpenzimeve > 15%	Vështirësi financiare Stoku i detyrimeve/Shpenzimeve > 25%	Vështirësi serioze financiare Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzimeve > 80%
0	0	0	0
Stuat Normale e gjendjes fina			

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-ës
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua shtatgjatë	0		
a.1	Principali	0		
a.2	Interesi	0		
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua	0		
b.2	Overdrafte	0		
b.3	Kredi të furnitorëve	0		
II	Detyrime (a+b+c)	2,723,115		2.13%
a	Shpenzime korrente	1,628,740		
a.1	Mallra dhe shërbime	1,101,180		
a.2	Paga dhe skajtim	0		
a.3	Të tjera	527,560		
b	Shpenzime kapitale	0		
b.1	Institucione buxhetore	0		
b.2	Subjekte private	0		
c	Vendime gjyqësore	1,094,375		
c.1	Marredhënie pune			
c.2	Mallra dhe shërbime			
c.3	Investime			
c.4	Të tjera	1,094,375		
III	Totali (I+II)	2,723,115	128,139,368	2.13%

Nëpunësi Zbatues

Liljana Pleçi

Shënim:

Stoku i detyrimit të mbetur duhet të rakordojë dhe Merzën e detyrimeve në sistemin e thesarit deri në periudhën për të cilën kryhet raportimi



KESHILLI I QARKUT KORÇE

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Per Periudhen e 8/mujorit 2021

në lekë

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	288800	6500000
1	Taksat e veta vendore	0	0
a.	Taksa mbi pasurinë		
b.	Biznesi i vogel		
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja		
d.	Taksa të tjera vendore		
2	Të ardhura jotatimore	288800	6500000
a.	Tarifat e shërbimeve publike		
b.	Tarifa administrative	188800	1000000
c.	Të tjera jo tatimore	100000	5500000
3	Taksa të ndara	0	0
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme		
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura		
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale		
e.	Të tjera		
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	40928640	128139308
1	Shpenzime Korrente	22006027	64211000
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	11384868	19339000
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1854482	3223000
d.	Shpenzime Operative	7956677	35761000
e.	Të tjera korrente	810000	5888000
2	Shpenzime Kapitale	18922613	63928308
3	Burimet e Financimit	101384681.1	128298794.1
a.	Të ardhurat e veta vendore dhe trashegimi I fondeve 2020	64080105.09	64080105.09


b.	Transferta e pakushtezuar	32641576	57757689
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtezuar sektoriale	4663000	6461000
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Nëpunësi Zbatues

Liljana Pleqi

Nëpunësi Autentues

Ana VERUSHI



KESHILLI I QARKUT KORCE

Plani i shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim

Nr.	Bashkia	Detyrimi i mbetur deri në 31 Gusht 2021	Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve			Diferencë (Fakt-Plan)	Shenime
			Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023		
	Keshilli i Qarkut Korçe	2,723,115	1,085,548	1,271,000	366,567	0	

Shënim

"Stoku i detyrimit të mbetur deri në dhjetor 2020" duhet të rakordojë me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit

Nëpunësi Zbatues

Liljana Pleqi



Nëpunësi Autorizues

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMITTE BUXHETIT TE VITIT 2021 PER PERIUDHEN 8/MUJORE

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” është hartuar Raporti për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën 8/mujore të vitit 2021.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për 8/mujorin është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr.68 /2017“Per financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 25.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 137/2020“ Për buxhetin e vitit 2021”*
- *Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018.“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 04 dt 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.*
- *Ne Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Per miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut per vitin 2021”si dhe ndryshimet e pesuara gjate vitit.*

Raporti paraqet punën e administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një ritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për 8 mujorin e parë 2021.

CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORÇE

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçës është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e koordinimin e politikave midis njesive të qeverisjes vendore të rajonit.

Këshilli i Qarkut Korçe ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë partnereve lokale e rajonale për pjesëmarrje në projekte gjithëpërfshirëse. Këshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij për pjesëmarrje në Programet ndërkufitare të financuara nga Bashkimi Europian, etj.me synim zhvillimit ekonomik social të Rajonit dhe ritjen e cilesisë së shërbimeve për komunitetin.

OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2021

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut për vitin 2021

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçe.*
- *Pjesëmarrja në Programet ndërkufitare e me gjere dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.*
- *Permirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njesive përbërëse të tij, në procesin e Integritimit Europian.*

REALIZIMI I BUXHETIT TE KESHILLIT TE QARKUT PER PERIUDHEN 8/mujore

Zbatimi i Buxhetit te Keshillit te Qarkut per periudhen 8/mujore ka ecur ne kushte normale, kjo si rezultat i nje planifikimi te mbeshtetur mbi burime reale te te ardhurave te vete Institucionit si dhe nje menaxhim te mire te shpenzimeve ne funksion te realizimit te aktiviteteve dhe programeve te planifikuara per kete vit.

Burimet e financimit :

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

Funksionet kryesore të strukturave financiare :

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

➤ Analiza e realizimit te te ardhurave per periudhen vjetore

Të ardhurat e veta per periudhen 8/mujore jane parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë ne konsiderate të dhënat e ecurisë së arkëtimit të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2020.

Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë periudhes kanë qënë si mëposhtë:

- Të ardhura nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut në funksion të shërbimeve që ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2020, të cilat janë planifikuar të përdoren për financimin e shpenzimeve të planifikuara për këtë vit buxhetor

Institucioni ka ecur drejt përmbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh një balance të drejte midis burimeve të financimit dhe realizimit të shpenzimeve në përmbushje të aktiviteteve dhe programeve të miratuara për këtë periudhë.

Te ardhurat në buxhetin e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:

ne 000/leke

Te ardhurat	Plani 8/M 2021	Fakti 8/M 2021	Realizim në %	Diferenca në leke
1. Transferta e pakushtezuar	43171	43171	100	0
2. Te ardhurat e veta	600	320	53.34	-280
a. Te ardhura nga tarifat	500	220	44.5	-280
b. Kontributi financiar i bashkive	100	100	100	0
3. Te ardhura të trashëguara 2020	64080	64080	100	0
4. Transferta e kushtezuar	4663	4663	100	0
Totali 4/M 2020	112514	112234	99.76	-280

Për 8/mujorin të ardhurat në buxhet janë realizuar në vlerë 112234 mijë leke ose 99.76% e planit, të ndara sipas natyrës janë:

Transferta e pakushtezuar me vlerë 43171 mijë leke është realizuar 100%, kjo e ardhur vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm i të ardhurave duke kapur rreth 38.5 % të buxhetit total për periudhën 8/mujore. Ajo është përdorur për financimin e funksioneve të veta në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Celja e saj është bërë në mbështetje të planit fillestar të buxhetit të ndarë në tremujore. Gjate periudhës nuk ka patur shtesa apo pakesime në këtë ze të buxhetit.

Realizimi i të ardhurave të vete institucionit për periudhën 8/mujore janë realizuar në vlerë 320 mijë leke ose 53.34 % e planit. Te ardhurat nga tarifat janë realizuar në masën 44.5 % e planifikimit 8/mujor. Theksojmë se kjo e ardhur planifikohet mbi bazën e realizimeve të saj në periudhat e mëparshme. Te ardhurat nga kontributi financiar i Bashkive pjesë përberëse e qarkut janë planifikuar të realizohen në periudhën në vazhdim. Në 8/mujor janë realizuar vetëm 100 mijë leke, derdhur nga Bashkia Maliq si detyrim i prapambetur nga viti 2020. Për muajin shtator priten të realizohen edhe 200 mijë leke të tjera nga ky kontribut. Krahasuar me planifikimin dhe realizimin faktik të tyre në bashkitë e qarkut, derdhja e këtij kontributi është në nivele shumë të ulta. Kjo vlen për të parë edhe në drejtim të përmirësimit të akteve ligjore për të bërë të mundur realizimin e kesaj të ardhure.

Te ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në total janë në vlerë 64.1 milion leke (grant + të ardhura) dhe janë celur në dy keste, kesti i parë me vlerë 43.8 milion leke është miratuar për përdorim me buxhetin fillestar dhe kesti i dytë prej 20.3 milion leke është miratuar për përdorim me vendim të Këshillit të Qarkut në muajin Mars. Këto të ardhura janë planifikuar të përdoren kryesisht në financimin e Projekteve IPA si dhe investime në infrastrukturë me përfitues Bashkitë e Qarkut. Pavarësisht celjes së tyre në 4/mujorin e parë, të ardhurat e trashëguara do të përdoren në vazhdimësi gjatë vitit në përmbushje të detyrimeve të planifikuara me Vendim të Këshillit të Qarkut.

Transferta e kushtezuar është një e ardhur e celur me destinacion për financimin e funksioneve të Drejtorise të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark. Ajo është celur sipas planit fillestar dhe një shtese buxheti në fondi i vecantë me vlerë 59 mijë leke. Ky fond është përdorur sipas planifikimit për paga, sigurime e shpenzime operative, si dhe një shperblim nga fondi i vecantë për rast dalje në pension.

Te ardhurat e realizuara në total janë përdorur për financimin e funksioneve të veta të përcaktuara si më poshtë:

- Paga të personelit,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.
- Për shpenzime operative
- Investime
- Bashkefinancim Projekte të BE
- Investime në infrastrukturë sipas propozimeve të bashkive dhe miratimit në Këshillin e Qarkut

➤ **Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën 8/mujore**

Shpenzimet e buxhetit gjatë periudhës 8 mujore janë realizuar në shumën prej **40927 mijë lekë** nga **111813 mijë leke** të planifikuara ose **36.61 %**.

Nga totali i shpenzimeve për periudhën 8/M, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **22003 mijë leke** ose **34.84%** ndaj planit prej **63164 mijë leke** sipas programeve të miratuara për administratën e keshillit të qarkut dhe drejtorinë e DAMT në qark.

Shpenzimet kapitale për periudhën janë realizuar në vlerë **18924 mijë leke** ose **46.24 %** e totalit të shpenzimeve faktike prej **40927 mijë leke**. Krahasuar me planin e periudhës 8/mujore për shpenzime kapitale që është **48649 mijë leke**, financimi i tyre është në nivelin 38.9 %. Në këtë mosrealizim kanë ndikuar vlerat e disa objekteve që janë në procedurë prokurimi. Gjithashtu vlera e investimit për obj. E Save Water është financuar nga fondet e celura nga donatori në bankën e nivelit të dytë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën 8/mujore e rakorduar me situacionin e thesarit paraqitet si më poshtë

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan 8/M	Fakt 8/M	Diferenca	% realizim
1	Administrata – Programi 01110	33142	12971	20171	39.14
	Paga personeli	9697	8659	1038	89.3
	Sigurime shoqërore e shëndetësore	1880	1430	450	76.1
	Shpenzime operative, keshilltare e vendime gjyqësore	7034	1949	5085	27.71
	Transferta korrente të brendshme	5888	810	5078	13.8
	Nga keto:				
	- Bashkia Korçë Projekti “Qendra ditore për mëshen e tretë”	3000	0	3000	0
	- Shoqatat e të verbërve	500	410	90	82
	- Qendra Kujdesit Shëndetësor Familjar – Kujdesi Palliativ	400	400	0	100
	- Projekti me Spitalin Rajonal Korçë	960	0	960	0
	- Korça Open Air 2020-2021	400	0	400	0

	- Aktivitete te shkollave te mesme te Rajonit	300	0	300	0
	- Shoqata e bleteritesve	328	0	328	0
	Transferta tek individet, familjaret	123	123	0	100
	Investime kapitale	8520	0	8520	0
2	Drejt.DAMT –Programi 01160	4722	3155	1567	66.82
	Paga personeli	3840	2543	1297	66.23
	Sigurime shoqerore e srendetsore	583	425	158	72.9
	Shpenzime operative	240	128	112	53.34
	Transferta tek individet, familjaret	59	59	0	100
3	Bashkefinancim ne Projekte me fonde Bashkimit Europian-Programi 08250	3500	717	2783	20.49
4	Projekti IPA – Wincome – Programi 04220	5500	3494	2006	63.53
5	Projekti IPA – Waste Rreact – Programi 05100	1500	0	1500	0
6	Projekti IPA – Save Water-Programi 06330	21131	4294	16837	20.32
7	Projekti IPA – Save Safe Water – Programi 06330	2700	1267	1433	46.93
8	Projekte ne aresimin baze e parashkollor Programi 09120	14896	3140	11756	21.08
9	Projekte ne rrjetin rrugor rural Programi 04520	24222	11889	12333	49.1
10	Fondi rezerve	500	0	500	0
	Total KESHILLI I QARKUT	111813	40927	70886	36.61

Analiza analitike e shpenzimeve përperiudhen 8/mujore, (për Administratën)

Buxheti i periudhes 8/mujore per administraten e Keshillit te Qarkut eshte realizuar ne nivelin **36.61 %** dhe ne vlere absolute **40927 mije** leke nga **111813 mije** leke te programuara. Menaxhimi i buxhetit per kete periudhe eshte bere sipas programeve te miratuara ne plan, duke ruajtur nje raport te drejte ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve. si dhe duke patur nje bilanc pozitiv te pagesave brenda limiteve te miratuara nga Keshilli i Qarkut. Niveli i ulet i realizimit lidhet me celjen e te ardhurave te trasheguara ne vlere 64 milion leke qe ne 4/mujor. Te ardhurat e trasheguara kapin rreth 57.25 % te planit te buxhetit te kesaj periudhe, nderkohe qe perdorimi i tyre do te shtrihet gjate gjithë vitit.

Duke analizuar treguesit financiare sipas strukturave, përdorimi i fondeve për shpenzime per kete periudhe rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente per Administraten jane realizuar ne nivelin 12917 mije leke nga 24622 mije leke te planifikuar ose 53 % sipas programit buxhetor. Ecuria e shpenzimeve korrente per paga, sigurime shoqerore e shpenzime operative ka qene ne perpjestim te drejte per cdo muaj duke permbushur te gjitha nevojat dhe detyrimet per funksionimin normal te Administrates. Mosrealizimi eshte kryesisht ne shpenzimet per detyrime te trasheguara si dhe ne aktivitetet qe do te mbeshete Keshilli i Qarkut, financimi i te cilave ka filluar ne muajin maj.

a. *Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)*

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për periudhën 8/mujore për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Administrata përbehet nga 13 punonjës, të cilët paguhen me nivelin e pagave të miratuara në Këshillin e Qarkut. Për periudhën 8/mujore kemi patur dy punonjës me leje lindje, të cilat janë zëvendësuar provizorisht. Ky zëvendësim ka ndikuar në nivelin e realizimit të fondit të pages. Fondet për financimin e këtyre shpenzimeve janë nga Transferta e Pakushtëzuara vitit 2021. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për këtë periudhë është në vlerën **10089 mijë leke ose 87.15 %** ndaj **11577 mijë leke** të miratuara sipas programit. Fondi i vecantë që për këtë periudhë është përdorur vetëm në nivelin 123 mijë leke në dy raste dalje në pension pleqërie.

b. Shpenzimet Operative, këshilltare dhe vendime gjyqësore (Artikulli 602)

Realizimi i shpenzimeve operative, këshilltare dhe vendime gjyqësore për këtë periudhë është bërë në mbështetje të programeve dhe aktiviteteve të miratuara në Këshillin e Qarkut. Nivelin e realizimit të këtyre shpenzimeve është 1949 mijë leke ose 27.71 % ndaj 7034 mijë leke të miratuara. Në këtë nivel realizimi kanë ndikuar procedurat e disa prokurimeve që po zhvillohen në periudhën në vazhdim. Gjithashtu edhe financimi i disa detyrimeve të trashëguara. Të gjitha shpenzimet me imediate janë realizuar dhe financuar 100 %. Nuk kemi vonesa në financimin e shpenzimeve. Nga analiza nivelin e shpenzimeve rezulton si më poshtë:

- Shpenzime për blerje dokumentacioni specifik janë realizuar në masën 64.8 mijë leke
- Shpenzime për energji, ujë telefona fix e celulare e shpenzime postare Art. 602.2 janë realizuar në nivelin 329.2 mijë leke
- Shpenzime për riparim automjete 118.8 mijë leke
- Shpenzimet për udhëtim e dieta Art. 6024 janë realizuar në nivelin 180.2 mijë leke, për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Covid 19, ky tregues është në nivele të ulta pasi të gjitha takimet me organizma ndërkombëtare janë zhvilluar online.
- Shpenzime për pagesa të vendimeve gjyqësore Art. 6027 janë realizuar në nivelin 401.9 mijë leke të cilat janë shpenzime për detyrime të trashëguara të parashikuara në borxhi si dhe një shpenzim gjyqësor i krijuar rrshtas.
- Shpenzime për pagesën e shpërblimit për anëtarët e Kryesise të Këshillit të Qarkut Art. 6029 janë realizuar në nivelin 588.7 mijë leke
- Shpenzime të tjera operative, si tarifa vendore Art. 6029 janë realizuar në nivelin 40 mijë leke

Të gjitha shpenzimet janë bërë sipas programit buxhetor të miratuar në Këshillin e Qarkut për periudhën 8/mujore. Likuidimi i detyrimeve është bërë edhe kundrejt amortizimit të tyre të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, si dhe në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 09 datë 18.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021".

c. Shpenzimet për Pagesat e Transfertave të Brendshme (Artikulli 604)

Në periudhën 8/mujore në këtë artikull janë financuar vetëm kontributi financiar i planifikuar për Shoqatat e të Verbërve të Qarkut Korce në vlerë 410 mijë leke, kontribut financiar për Qendren e Sherbimit Paliativ Korce në vlerë 400 mijë leke. Aktivitetet e tjera të planifikuara do të vazhdojnë të financohen.

Analiza e shpenzimeve për 8/M për funksionet e deleguara (DAMT në qark)

Keshilli i qarkut ne permbushje te funksioneve te deleguara si funksioni i Drejtorise te Administrimit dhe Mbrojtjes te Tokes ne qark, ka te programuar ne Buxhetin e tij edhe fonde nga transfertat e kushtezuar, te cilat delegohen nga Buxheti i Shtetit.

Gjatë kesaj periudhe, shpenzimet e përgjithshme për funksionimin e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë realizuar në shumën 3155 mije lekë nga 4722 mije lekë te planifikuara ose 66.82 %. Shpenzimet e bera per kete funksion jane financuar 100 %. Ne kete mosrealizim ka ndikuar mungesa e nje punonjesi per periudhen 4 mujori i pare dhe per 4/mujorin e dyte 2 punonjes.

Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)

Shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore perperiudhen 8/M për punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Ministria e linjës si dhe nivelit të pagave te miratuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

